



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 15. 11. 2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Xhavit Haliti, Arben Gashi, Fatmir Xhelili, Bislim Zogaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Vjosa Osmani, Valdete Bajrami, Kujtim Paçaku dhe Slobodan Petroviq.

Të ftuar: Anila Statovci zv. ministre e Integritimeve Evropiane me bashkëpunëtorët.

Në mbledhje morën pjesë edhe disa anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa: Safete Haderxhonaj, Shukri Buja, Besa Gaxheri dhe Bali Muharemaj.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Njomza Emini, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-124 për Ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Time Kadrijaj propozoi që në rendin e ditës, për shqyrtim të futet Projektligji për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, *ndërsa kryetarja* konstatoi se rendi i ditës u miratua me këtë plotësim .

2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-124 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;

Kryetarja e Komisionit, në lidhje me këtë Marrëveshje, ia dha fjalën zëvendësministres **Anila Statovci**, për të njoftuar lidhur me qëllimin, përmbajtjen dhe obligimet e institucioneve të Kosovës , rreth kësaj marrëveshjeje.

Anila Statovci, zëvendësministre, theksoi se bashkëpunimi ynë si ministri me komisionin tuaj është obligim në kuadër të mbarëvajtjes së punës që kemi.

Marrëveshja financiare për IPA 2015 është program me qëllim të financimit të 16 projekteve me vlerë prej 78 milionë euro , financim ky që jepet drejtpërdrejt nga BE-ja, ndërsa Republika e Kosovës merr pjesë në formë të bashkëfinancimit prej 3 milion euro .

Për herë të parë në kuadër të IPA-2 financohen 3 sektorë kryesorë: sundimi i ligjit, sektori i energjisë dhe sektori i bujqësisë dhe zhvillimi rural. Përveç këtyre sektorëve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare ka përkrahje dhe mbështetje edhe për procesin e integritimit evropian, për përafrimin ligjor me BE-në si dhe nevojat për financim për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas përfundimit të negociatave të përmbajtjes, të programit IPA 2015 për Kosovën, kanë përfunduar të gjithë hapat procedural të paraparë për miratimin e kësaj marrëveshjeje financiare dhe për shkak të afateve kontraktuale të Zyrës së BE-së, Projektligji duhet të hyjë në fuqi para datës 31 dhjetor të vitit 2016 .

Në vazhdim **Njomza Emini, kryetare e** hapi diskutimin.

Fatmir Xhelili kërkoi sqarim pse IPA 2015, a paraqet kjo diçka dhe mos e konsideron dikush që nuk po dimë çka po votojmë në këtë drejtim, përndryshe duke marr parasysh rëndësinë e këtij Projektligji, ai tha se e përkrah atë dhe do ta votojë.

Zv.ministrja Statovci theksoi se keni të drejtë, por IPA 2015 shënon vitin kalendarik kur është përpiluar marrëveshja dhe pastaj si e tillë mbetet si proces, ndërsa implementimi duhet të fillojë menjëherë që nga janari i vitit 2017, prandaj, tha kërkohet edhe aprovimi deri më 31 dhjetor 2016.

Kryetarja Njomza Emini bëri të qartë se pas leximit të parë, janë ngarkuar për shqyrtim Komisioni për Integritet Evropian dhe Komisioni për Buxhet, t'ua japim së pari fjalën anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Safete Hadërgjonaj, anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se ne jemi për miratimin e këtij Projektligji. Si Komision për Buxhet këtu jemi për koston buxhetore të këtij projektligji dhe jemi për këtë marrëveshje financiare me IPA-në, por nga vlerësimi që është bërë

nga Departamenti për Buxhet, shohim se nuk është përfshirë kostoja buxhetore në projeksionet buxhetore 2017-2019. Ministria e Financave është arsyetuar se nuk na ka marr asnjë kërkesë nga Komuna e Prishtinës dhe e Gjakovës, për tu përfshirë në Buxhet.

Ministria e Integritimit sipas kësaj që kemi përpara ka thënë se ne do të angazhohemi që në të ardhmen të përfshihen në kuadër të projeksioneve buxhetore.

Sugjerohet nëse votohet në Kuvend, ju duhet të komunikoni me ministrin e financave dhe meqenëse jemi në fazën e amendamentimit të buxhetit në Kuvend të gjeni mundësinë që të përfshihen në buxhet, në mënyrë që ky ligj të jetë i zbatueshëm.

Shukri Buja, anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se programet e IPA-së nuk janë të reja në kuptimin e investimeve, sepse këto programe vazhdimisht kanë qenë funksionale. Si nuk e ka dit Qeveria për koston buxhetore, kur Ministria për Integritimit Evropian është hartuese e këtij projektligji. Këtu nuk janë në pyetje komunat, sepse janë të përfshira vetëm dy komuna dhe 3 milion euro është kosto e madhe, nuk mundet asnjëra komunë ti përballojë, pra e vetmja mundësi është që Ministria e Financave, së bashku me Ministrin e Integritimit, të shikojnë mundësinë e futjes së Projektligjit i cili është në procedurë në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Besa Gaxheri, anëtare e Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se lidhur me këtë çështje kaq te rëndësishme nuk duhet ti komplikojmë gjërat, ngase nëse nuk janë përfshi 3 milion euro në buxhet, ne jemi këtu me krye këto punë si deputetë, në aspektin legjislativ ne si Komisione duhet ta shqyrtojmë dhe amendamentojmë Ligjin kurse aspektet tjera, ju duhet si ministri ti shikoni, në mënyrë që të përmbillet kjo çështje.

Xhavit Haliti pyeti pse po marrin pjesë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa në këtë mbledhje dhe kush i ka ftuar. Paraprakisht është dashtë të njoftohemi për pjesëmarrjen e tyre për të debatuar së bashku për një çështje.

Njomza Emini, kryetare, sqaroi se pasi që me vendimin e Kryetarit të Kuvendit janë ngarkuar për shqyrtim Komisioni për Integritimit Evropian dhe Komisioni për Buxhet, ne i ftuam që të marrin pjesë dhe ta shqyrtojmë së bashku Projektligjin.

Safete Hadergjona, theksoi se duke u bazuar në vendimin e kryetarit dhe ftesës së Komisionit, ne erdhëm për të debatuar dhe nëse miratohet marrëveshja, atëherë ne si Komision së bashku me Ministrin për Financa, ta gjejmë mënyrën se si ta amendamentojmë.

Anila Statovci, zëvendësministre, tha se bashkëpunimi me BE-në është tejet i rëndësishëm. Bashkëfinancimi ynë është vetëm 3 milion euro, kundrejt 78 milionë të BE-së dhe në njëfarë mënyre është më tepër si simbol i seriozitetit tonë për të ecur me këto projekte.

Për të sqaruar më tepër për çështjet financiare ia kaloi fjalën sekretarit të ministrisë për Integritimit Evropian

Demush Shasha- sekretar në Ministrinë për Integritimit Evropian tha se Ministria e Financave e din më së miri kur i lëshon opinionet, ato i lëshon në bazë të numrave dhe tabelave që janë në fuqi. Është e vërtetë që 3 milion euro nuk figurojnë në buxhet dhe në së bashku me kolegët e zyrës së BE-së kemi gjet zgjidhje për këtë. Nuk ka nevojë të ndryshohet Projektligji i buxhetit për

vitin 2017. Marrëveshja do të ketë afat 5 vjeçar të zbatimit, dhe bashkëfinancimi jonë prej 3 milion, në cilindo vit, në 5 vitet e ardhshme kudo që i gjejmë ata 3 milion, mund të bëhet zgjidhja.

Kryetarja e komunës së Gjakovës dhe kryetari i Prishtinës, kanë dërguar letra në Ministri të Financave, ku kanë njoftuar se do të dorëzojmë zyrtarisht te KASH-i kërkesat për vitin buxhetor 2018-2019. Ministri i financave do të gjejë mënyrën më të mirë se ku do të programohen këto mjete.

Sa i përket afateve kohore, shpesh kjo nxit konfuzion por i tillë është sistemi i fondeve të BE-së, i themi IPA 2015 sepse çdo gjë është programuar në vitin 2015.

Pas diskutimeve dhe votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë;

Rekomandim

Të miratohet Projektligji Nr. 05/L-124 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian .

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-117 për Akreditim, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja paraqiti opinion ligjor lidhur me këtë projektligj. Pas shqyrtimit dhe verifikimit vlerësojmë se ky projektligj së bashku me amendamentet e komisionit funksional nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Lidhur me këtë hapi diskutimin.

Fatmir Xhelili theksoi se vlerësimet buxhetore duhet të bëhen jo vetëm për këtë Projektligj, por edhe për disa projektligje tjera ,sepse disa projektligje kur po aprovohen tërheqin edhe renditjen e disa strukturave që janë të kushtueshme për shtetin tonë dhe faza për anëtarësim në BE është bukur e gjatë , andaj pyeti se a ka ndonjë ekip apo së paku ministria a i bënë planifikimet për 5-6 vitet e ardhshme se në çfarë momente kohore cilat ligje duhet me aprovu për mos me e ngarkuar buxhetin tonë. A i vlerëson dikush këto gjëra ?

Kryetarja pas votimit konstatoj se komisioni një zëri nxori këtë ;

Rekomandim

Projektligjit Nr.05/L-117 për Akreditim, me amendamentet e Komisionit Funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në seancë plenare.

Në vazhdim kryetarja kaloi në pikën e plotësuar të rendit të ditës me kërkesë të deputetes Time Kadrijaj, që të shqyrtohet edhe Projektligji në vijim

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij;

Kryetarja sqaroi se ky Projektligj është nismë legjislative e deputetëve të Kosovës .

Projektligji së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, është shqyrtuar dhe është konstatuar se fusha të cilën e rregullon ky Projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional mund te rekomandohet për miratim në procedurë te rregullt në Kuvend.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë;

Rekomandim

Projektligjit për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

5. Të ndryshme .

Kryetarja rikujtoi anëtarët se me kohë do të njoftohen për temat dhe kohen e mbajtjes se tryezës me shoqërinë civile, për të cilën u patën dakorduar në mbledhjen e kaluar.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini